# Raporti i Monitorimit

Monitorimi efikas i zbatimit të ligjit mbi kontrollin e duhanit, Maj – Nëntor 2013

Kosovo Advocay and Development Centre
Prishtinë

## Monitorimi dhe analiza

Raporti i monitorimit të punës së inspektoratit shëndetësor pasqyron punën e inspektorëve sipas inspektimeve të regjitruara në periudhën maj – nentor 2013

Autoritetet për zbatim sipas ligjit për kontrollin e duhanit janë: inspektorati sanitar, shëndetsor, arsimor, transportit, punës, tregut, Policia e Kosovës dhe agjensioni kundër korrupsionit. Projekti ka monitoruar punën e inspektoratit shëndetësor. Gjatë periudhës monitoruese janë kryer një numër i vizatave inspektuese në të gjitha institucionet shëndetësore të vendit. Deri në fund të raportit janë regjistruar 124 vizita, prej tyre janë shqiptuar 2 gjoba mandatore.

Gjatë monitorimit katër mujor të zbatimit të ligjit për kontrollin e duhanit janë identifikuar një numër i zbrazëtirave dhe vështirësive për zbatim efikas të ligjit:

Numri i vogël i inspektorëve për zbatimin e ligjit, rezistenca e inspektorëve për të bërë vizita inspektuese gjatë natës, jo koordinimi dhe bashkëpunimi në mes të inspektorëve lokal dhe qendror, mungesa e tiketave unike për lëshimin e gjobave mandatore, vonesa në lëshimin e udhëzimeve administrative të parapara me ligj, përpilimi jo cilësor i lëndëve për kundërvajtje nga ana e inspektorëve (mungesa e dëshmive) dhe procedimi joefikas i lëndëve të ngritura në gjykatën për kundërvajtje.

Pas regjistrimit të 124 vizitave inspektuese nga terreni në sistemin softuerik është bërë analiza e performancës së inspektorëve. Kryeinspektorja në çdo moment ka qasje në punën dhe performancën e secilit inspektor.

Sistemi gjeneron raporte sipas llojit të inspektimeve (tematike apo të planifikuara), sipas inspektorit, subjektit, regjionit, vendit apo komunës, repartit, pronësisë (privat apo publik), nivelit të kujdestarisë apo orës kur është kryer inspektimi. Këto raporte mundësojnë analizën e dobësive dhe përparësive në zbatimin e ligjit në institucionet shëndetësore.

## Rekomandimet

Nga monitorimi i punës së inspektorëve shëndetësor dalin këto rekomandime:

1. Të rritet numri i inspektorëve;
2. Të inkurajohen dhe stimulohen për punë edhe jashtë orarit të rregullt zyrtar, për vizita inspektuese gjatë natës;
3. Organizimi i takimeve të rregullta mes inspektorëve lokal dhe qendror, shkëmbimi i përvojave dhe rasteve nga terreni;
4. Krijimi i tiketave unike me të cilat do të bëhej i mundshëm realizimi i gjobave mandatore (50 euro) në vendin e ngjarjes;
5. Mbështetje Ministrisë së Shëndetësisë për draftimin e udhëzimeve administrative, planit vjetor dhe avokimi në përshpejtimin e miratimit të tyre;
6. Trajnimi i inspektorëve për përpilimin cilësor të lëndëve për kundervajtje (mbështja në fakte, dëshmi) në bashkëpunim me gjyqtarët për kundërvajtje;
7. Furnizimi i inspektorëve me sistemin harduerik (tablet) për regjistrimin e vizitave inspektuese në terren për përshpejtimin dhe automatizimit të tërë procedurës inspektuese.

# Sistemi Softuerik “Inspektimi shëndetësor”

Më poshtë janë pjesë nga sistemi softuerik i zhvilluar për inspektoratin shëndetësor:



Fillimi | Vizita ▾ | Raportet ▾ | Administ

# FORMULARI PËR VIZITË INSPEKTUESE

Kerko subjektin [ ] Kerko | Regjistro subjekt te ri

Inicimi [ ]

Data 01/23/2014

## Historiati i Subjektit

## Inspektoret

| | | |
|---|---|---|
| 0419<br>**Shaban Osmanaj** | 114<br>**Ardita Baraku**<br>ardita.baraku@rks-gov.n | 0419<br>**Advije Malaj** |
| 0245<br>**Bashkim Vatovci** | 0571<br>**Hyrije Kabashi** | 0569<br>**Diana Shehu-Devaja** |
| 0699<br>**Fakete Hoxha-Haziri** | 0461<br>**Nora Krasniqi** | |

## Zgjedh repartin

- [ ] Reparti i psikiatrisë
- [ ] Klinika e Oftalmologjisë
- [ ] Shërbimi emergjent dhe ambulancave specialistike
- [ ] Sherbimi i stomatologjise
- [ ] Sherbimi i radiologjis dhe Laboratorit
- [ ] Sherbimi Mjekesi familjare
- [ ] Oftamologjisë, Kirurgjise, Anestezionit dhe Urologjise

## INSPEKTIMI

- [ ] Shenjat e ndalimit të prijes nuk janë vendosur
- [ ] Janë të vendosura shenja të vjetra të ndalimit të pirjes së duhanit
- [ ] Taketuket prezente
- [ ] Ka tym duhani apo indikator tjerë të pirjes:
- [ ] Ligji respektohet
- [ ] Duhani konsumohet në afërsi të hyrjeve-daljeve
- [ ] Personi konsumon produkte te duhanit
- [ ] Në institucion përfshirë dhe oborrin shiten produkte të duhanit

ProcesVerbal [ ]

Fillimi Vizita ▾ Raportet ▾ Administrimi ▾ Ju! ▾

# Raportet

Zgjedh Raportin: sipas Vendit  Zgjedh Vendin: Prishtinë

Data prej: 23-05-2013  Data deri: 23-11-2013  Kerko  Print

| Lënda | Institucioni | Regjioni | Komuna | Vendi | Reparti | Niveli kujdesit | Data | Inspektori | Masa e ndërmarrë | Statusi i lëndës |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 121 | QKMF / Publike | Prishtinë | Prishtinë | Prishtinë | Sherbimi i Pediatrise | Parësor | 16/08/2013 15:05 | Shaban Osmanaj Nora Krasniqi | Ligji respektohet | |
| 123 | QKUK / Publike | Prishtinë | Prishtinë | Prishtinë | Klinika Emergjente | Tretësor | 12/08/2013 13:00 | Shaban Osmanaj Diana Shehu-Devaja | Ligji respektohet | |
| 124 | QKUK / Publike | Prishtinë | Prishtinë | Prishtinë | Klinika Infektive | Parësor | 12/08/2013 12:16 | Shaban Osmanaj Diana Shehu-Devaja | Ligji respektohet | |
| 120 | Simoni Optika / Private | Prishtinë | Prishtinë | Prishtinë | n.a | Parësor | 09/08/2013 19:50 | Shaban Osmanaj Nora Krasniqi | Ligji respektohet | |
| 119 | Kavaja Hospital / Private | Prishtinë | Prishtinë | Prishtinë | n.a | Dytësor | 09/08/2013 18:15 | Shaban Osmanaj Nora Krasniqi | Ligji respektohet | |